

Potenciali tregtar Kosovë - Shqipëri:

pengesat dhe zbatimi i marrëveshjeve bilaterale

Mars, 2020



Draft

Potenciali tregtar Kosovë - Shqipëri: engesat dhe zbatimi i marrëveshjeve bilaterale

MARS, 2020

Financuar nga:

Ky studim është pjesë e projektit "Shqipëri – Kosovë, Dekonstruktimi i idesë së bashkimit – Perceptimet e qytetarëve për bashkëpunimin mes dy vendeve". Ky projekt është iniciuar dhe mbështetur financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS dhe Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë – OSFA.

Deklaratë mohimi:

Gjetjet, opinionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë stufim janë të autorëve dhe të kontribuuesve institucionalë. Si të tilla, ato nuk reflektojnë medoemos pikëpamjet e Fondacionit të Shqipërisë për Shoqëri të Hapur dhe të Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur.

Kontribuesit:

Instituti Riinvest dhe Institutti GAP

Dizajni dhe Faqosja:

Envinion

Originali është shkruar në shqip.



Rr. Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr.4, 10000 Prishtinë

+383 38 609 339

info@institutigap.org

© All rights reserved - Institutti GAP 2020

Përbajtja

Përbledhje ekzekutive 7

1. Hyrje 8

2. Metodologjia 10

3. Regjimi tregtar 12

4. Tregtia e mallrave në mes Kosovës dhe Shqipërisë 15

5. Zbatimi i marrëveshjeve për lehtësimin e tregtisë 22

6. Barrierat tarifore dhe jo-tarifore 25

7. Potencialet për shkëmbime tregtare
dhe tregtia ndërsektoriale 28

8. Përfundimet 32

Anekset 33

Përbledhje ekzekutive

Ky studim ka për qëllim vlerësimin e potencialit tregtar mes Kosovës dhe Shqipërisë si dhe identifikimin e barrierave tregtare të cilat po e pamundësojnë shfrytëzimin e këtij potenciali. Për më tepër, për herë të parë është bërë edhe një analizë e zbatimit të marrëveshjeve të cilat prekin çështjet e shkëmbimeve të mallrave në mes dy vendave. Të dhënët e mbledhura për këtë studim reflektojnë gjendjen deri në fund të muajit shtator 2019.

Rezultatet tregojnë se megjithëse ka një progres të mirë në realizimin e marrëveshjeve, ende shfaqen pengesa të cilat nuk rregullohen me këto marrëveshje. Pothuajse në të gjithë sektorët eksportues të Kosovës ka potencial përritje të bashkëpunimit tregtar me Shqipërinë. Pra, sasia e mallrave të eksportuara në Shqipëri nuk reflekton potencialin eksportues të Kosovës në Shqipëri. Në anën tjetër, janë identifikuar një mori pengesash të cilat po e pamundësojnë shfrytëzimin e këtij potenciali. Këto pengesa janë kryesish të karakterit teknik mirëpo në raste specifike ato shfaqen edhe në formë të barrierave tarifore. Ndër pengesat kryesore që janë identifikuar në këtë studim përfshijnë dyfishimin e procedurave përmallrat që kalojnë tranzit në territorin e Shqipërisë, pagesat për skanim të mallrave në portin e Durrësit pavarësisht destinacionit final, tarifa e lartë rrugore, çmimet referente, akcizat diskriminuese, dokumentacione shtesë sanitare dhe fitosanitare, etj. Një pjesë e pengesave të raportuara nga bizneset eksportuese në Kosovë janë adresuar vetëm përkohësisht pas intervenimit të autoriteteve përkatëse në Shëipëri dhe të njëjtat sipas këtyre bizneseve janë përsëritur në mënyrë sistematike. Gjithashtu, ka një diskrepancë mes të dhënave zyrtare të raportuara në Kosovë dhe

Shqipëri për shkëmbimin e mallrave, pavarësisht se harmonizimi i procedurave si dhe shkëmbimit të informacionit ishte paraparë me njëren nga marrëveshjet e nënshkruara.

Në mënyrë që të shfrytëzohet potenciali ekonomik për shkëmbime tregtare mes dyja vendave, në këtë raport janë dhënë një sërë rekomandimesh. Si parakusht përritje të mëtutjeshme të shkëmbimeve të mallrave mes dy vendave duhet të jetë prioritet forcimi i sundimit të ligjit, rritja e kapaciteteve institucionale dhe ulja e pengesave burokratike. Për më tepër, të dy vendet duhet që të punojnë në harmonizimin e mëtutjeshëm të standardeve ushqimore dhe të shkojnë edhe një hap tutje që të harmonizojnë disa prej taksave apo akcizave të cilat do të ndihmonin në shmangjen e diskriminimit të produkteve të vendit tjetër. Sa i përket funksionimit të institucioneve, të dy qeveritë duhet të bëjnë përpjekje të shtuara që të intensifikohet komunikimi dhe koordinimi sa i përket hartimit të politikave dhe zbatimit të tyre. Së fundmi, duhet të krijohet një program i mbështetjes përmes taksave apo akcizave të cilat kanë potencial të madh të rritjes së shkëmbimeve tregtare.

1. Hyrje

Shqipëria dhe Kosova janë partnerë të rëndësishëm tregtar për njëra-tjetrën. Për Kosovën, Shqipëria zë vendin e parë sa i përket eksporteve dhe vendin e pestë sa i përket importeve. Shqipëria është e rëndësishme për Kosovën në aspektin tregtar edhe për arsy se më shumë se një e treta e produkteve të tregtuara në Kosovë kalojnë tranzit përmes saj. Të dy vendet janë po ashtu edhe anëtare të Marrëveshjes për tregti të lirë në Evropën Qendrore (CEFTA) e cila synon eliminimin e barrierave tregare qofshin ato tarifore apo jo-tarifore. Për më tepër, Kosova dhe Shqipëria nuk janë mjaftuar vetëm me këtë marrëveshje të karakterit rajonal, por kanë nënshkruar marrëveshje, memorandum apo vendime qeveritare të tjera të cilat rregullojnë çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me tregtinë si: harmonizimi i standardeve ushqimore, përspejtimi i procedurave të tranzitit, shkëmbimi i standardeve, themelimi i pikave të përbashkëta kufitare, bashkëpunimi në fushën e hetimeve doganore, bashkëpunimi në akreditim të laboratorëve etj. Hapja e një zyreje të vetme doganore të Kosovës në Portin e Durrësit në Shqipëri paraqet një përafrim tjetër të marrëdhënieve shtetërore e tregtare të Kosovës dhe Shqipërisë. Nënshkrimi i gjithë këtyre marrëveshjeve me obligime specifike, tregon një avancim në marrëdhënet tregtare të dyja vendeve. Mirëpo, me gjithë nënshkrimin e një numri të madh të marrëveshjeve, eksportet kosovare ende përballen me bariera tregtare mbi shkëmbimin e mallrave.

Qëllimi i këtij studimi është që për herë të parë të bëjë një vlerësim të zbatimit të marrëveshjeve tregtare

Kosovë – Shqipëri dhe një analizë të detajuar të barrierave tregtare që bizneset Kosovare ballafaqohen në raport me Shqipërinë. Në këtë analizë gjithashtu për herë të parë paraqiten shkëmbimet tregtare mes dyja vendeve në bazë të klasifikimit të industrive dhe një analizë indikative lidhur me sektorët industrial që kanë potencial për rritje të eksporteve nga Kosova për në Shqipëri. Duhet pasur parasysh se ky studim paraqet vetëm perspektivën e Kosovës në raport me çështjet tregtare Kosovë – Shqipëri. Paralelisht me këtë studim, publikohet edhe një hulumtim nga Shqipëria i cili paraqet problematikat tregtare në raport me Kosovën. Gjithashtu, ky studim fokusohet vetëm në tregtinë e mallrave, duke mos e përfshirë tregtinë e shërbimeve.

Për të kuptuar më mirë problemet tregtare, zbatimin e marrëveshjeve dhe nivelin aktual të shkëmbimeve tregtare është më rëndësi që të kuptohen disa faktorë që lidhen me kontekstin e ekonomive të të dyja vendeve. Shqipëria ka pothuajse dyfish Bruto Produkt Vendor (BPV) më të lartë se Kosova dhe një-kohësisht pjesëmarrja e industrisë në BPV është më e lartë.¹ Sipas Komisionit Evropian (KE), pengesë për zhvillimin e sektorit privat në Shqipëri është korruptioni gjérësish i përhapur, ndryshimet e shpeshta të kornizës rregullative për biznese, dhe rritja e numrit të kontratave me partneritet publiko-privat pa procedura të mirëfillta konkurrimi në prokurim publik që mund ta rris ndikimin e shtetit në ekonomi. Mungesa e dijes (know-how) dhe kualiteti i ulët i edukimit, bëjnë që Shqipëria të mos e shfrytëzoj potencialin e saj për integrim regional dhe eksport. Gjithash-

1 World Bank, World Development Indicators

tu, sektori privat është i koncentruar tek një numër i vogël i kompanive ku 75% e punësimit formal dhe 86% e investimeve në ekonomi gjenerohen nga pesë përqind e bizneseve. Pengesë për konkurrueshmëri të barabarte në sektorin privat është edhe ekonomia informale që llogaritet të jetë sa një e treta e BPVsë. Sa i përket lëvizjes së lirë të mallrave, Shqipëria e ka të përafruar me BE-në legjislacionin për akreditim dhe mbikëqyrje të tregut, ndërsa të gjitha standardet i ka në përputhje të plotë me BE-në. Në fushën e taksave, legjislacionin për akciza Shqipëria e ka vetëm pjesërisht të përafruar me BE-në.²

Probleme të ngjashme sikurse Shqipëria ka edhe Kosova. Sipas KE-së, edhe në Kosovë pengesë për zhvillimin e sektorit privat është korrupzioni gjërësisht i përhapur, ekonomia informale deri në një të tretë e BPV-së, mungesa e fuqisë punëtore kualitative dhe funksionimi i ngadaltë i gjyqësorit. Gjithashtu madhësia e tregut dhe kërkesa e kufizuar– pjesërisht nga mundësitetë e limituara për qasje në tregjet e eksportit konsiderohet si një nga barrierat kyçë për zhvillimin e sektorit privat në Kosovë.³ BPV për kokë banori e Kosovës është më e ulëta në rajon, ndërkohë që mesatarja e pagave është e dyta më e larta që tregon për një konkurrueshmëri të ulët të ekonomisë. Faktor tjetër i cili pengon konkurreshmërinë e Kosovës është madhësia e bizneseve ku 99% prej tyre janë biznese të vogla me më pak se 10 persona të punësuar. Kosova ka qasje të kufizuar në standardet Evropiane, ndërsa trupat akredituese nuk i plotësojnë kërkosat për qasje në Marrëveshjet Multilaterale për

Bashkëpunim Evropian të Akreditimit. Në fushën e doganave, Kosova duhet që tutje të përafrojë legjislacionin për dogana dhe gjithashtu të largojë akcizat diskriminuese për duhanin.⁴ Gjithashtu, Kosova aplikon një tarifë për kamionët të cilët duhet të futen në terminale private për t'i kryer obligimet tarifore dhe e cila nuk është në përputhje me EU acquis. Kosova duhet ta forcojë infrastrukturën për sigurimin e cilësisë, ndërsa trupat inspektuese të tregut nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për mbikëqyrjen e tregut. Së fundmi, Ligji për mbrojtjen e konsumatorit i cili kërkon paraqitjen e flamurit të vendit të origjinës nuk është në linjë me eu acquis.

Ky hulumtim është i organizuar si në vijim. Pjesa e hyrjes paraqet një përvashim të shkurtër kronologjik të ngarjeve që kanë karakterizuar bashkëpunimin tregtar mes dy vendeve përgjatë dy dekadave. Seksioni i dytë përvashuan metodologjinë e studimit. Regjimi tregtar i Kosovës përfshirë edhe të gjitha marrëveshjet mes dy vendeve të cilat prekin fushën e tregtisë janë të elaboruara në seksionin e tretë. Në pjesën e katërt dhe të pestë ky raport në mënyrë kuantitative analizon të dhënat e shkëmbimeve tregtare në mes dy vendeve respektivisht sfidat në implementimin e marrëveshjeve të nënshkruara. Barrierat e identikuara dhe efekti i tyre në tregtinë mes Kosovës dhe Shqipërisë si dhe potencialet përritje të mëtutjeshme të bashkëpunimit tregtar janë të paraqitura në seksionet shtatë respektivisht tetë. Të gjeturat kryesore të studimit si dhe rekomandimet janë të përmbledhura në seksionin e fundit.

2 European Commission, Albania 2019 Report, Burimi: <https://bit.ly/2J0g6w2>, faqe 47, 50, 51, dhe 75

3 Instituti Riinvest, Ambienti Biznesor në Kosovë 2017, Burimi: <https://bit.ly/2PyQWTg>

4 European Commission, Kosovo 2019 Report, Burimi: <https://bit.ly/2KckkwX>

2. Metodologjia

Me qëllim të matjes së zbatimit të marrëveshjeve tregtare të nënshkruara në mes të Republikës së Kosovës dhe Shqipërisë, fillimi i janë përdorur burimet sekondare të të dhënave për identifikimin e marrëveshjeve në fushën e tregtisë. Shumica e marrëveshjeve nuk gjenden të publikuara në Gazetën Zyrtare të Kosovës, prandaj janë kontaktuar institucionet përkatëse në Kosovë për qasje në dokumente. Me qëllim të matjes së realizimit të marrëveshjeve, fillimi i janë identifikuar objektivat specifike të cilat i përbajnjë marrëveshjet – 53 objektiva. Përgjegjësia përzbatimin e këtyre objektivave është ndarë në bazë të institucioneve përkatëse si: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Dogana e Kosovës, dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës. Pas realizimit të intervistave me këto institucionë, pyetësorët e shkruar janë dërguar tek këto institucionë dhe për secilën pyetje kanë mundur të përgjigjen me “Po” - objektivë e realizuar; “Jo” - objektivë e parealizuar; dhe “Pjesërisht” - objektivë e realizuar pjesërisht. Përveç plotësimit të pyetësorit nga institucionet zyrtare, janë kontaktuar edhe bizneset përfundimtarë i zbatimit të marrëveshjeve zbatohen në praktikë. Vlerësimi përfundimtar i zbatimit të marrëveshjeve është bërë nga hulumtuesit e Institutit GAP dhe Riinvest duke u bazuar në informata e mbledhura nga institucionet, bizneset si dhe burimet tjera.

Të dhënët lidhur me barrierat tregtare janë mbledhur përmes të dhënave sekondare dhe primare. Të dhënët sekondare janë marrë nga raportet e publikuara ndërsa ato primare përmes intervistave me asocacionet e bizneseve si dhe vetë bizneset të cilat janë ballafaqur

me këto bariera. Disa prej këtyre barrierave janë konfirmuar duke kontaktuar palë të treta dhe duke konsultuar bazën ligjore në Shqipëri, mirëpo raportimet përrastë të veçanta të korruptionit janë të pa verifikuara. Të dhënët kuantitative për shkëmbimet tregtare të raportuara nga Kosova dhe Shqipëria janë mbledhur nga Eurostat si burim që ofron të dhënët tregtare përrastë dy vendet përnjë periudhë të gjatë kohore. Këto të dhëna janë të analizuar në nivel produktesh apo kodit tarifor gjashtë shifrontë raportuara sipas nomenklaturës së kombinuar nga sistemi i harmonizuar.⁵ Të dhënët pastaj janë agreguar në nivel industrie duke i konvertuar në divizionë respektive sipas NACE (nomenklatura Evropiane përklasifikimin e aktiviteteve ekonomike) në bazë të tabave zyrtare përkonvertimin e kodeve tarifore sipas agjencisë UNSTAT të Kombeve të Bashkuara.^{6,7}

Analiza e potencialeve të tregtisë në mes Kosovës dhe Shqipërisë është e bazuar në metodologjinë e Qendrës Ndërkombëtare për Tregti (ITC), e cila sygjeron disa metoda studimi përrastë të ndryshme analitike.⁸ Një prej metodave është e bazuar në një model graviteti i cili preferohet të përdoret përrastë studiuar tregtinë e jashtme në nivel sektorial të indistrisë. Një metodë tjetër që mund të përdoret në këtë kontekst është edhe vlerësimi i potencialit tregtar përmes disa indikatorëve të përafërt si Potenciali tregtar indikativ, në original “Indicative trade potential (ITP)” dhe “Relative indicative trade potential (RITP)” apo Potenciali Tregtar Indikativ Relativ. Një metodë e tillë zakonisht preferohet të përdoret përrastë analizuar tregtinë e jashtme në nivel të mallrave të tregtuar. Për shkak se përcaktuesit e treg-

5 Harmonized System

6 UN Correspondence Tables, Burimi:<https://bit.ly/3IjxmXN>

7 NACE Rev. 2. Statistical classification of economic activities in the European Community. <https://bit.ly/2pQXPW7>

8 Helmers, Christian, dhe Jean-Michel Pasteels. “Assessing Bilateral Trade Potential at the Commodity Level: An Operational Approach.” International Trade Center (ITC), 2006, 10–12. <https://bit.ly/2WaZT7C>.

tisë së jashtme në nivel të sektorëve industrial mund të janë të ndryshëm prej përcaktuesve në nivel të mallrave të tregtuar, një analize sektoriale duhet patjetër t'i bashkëngjitet edhe një analizë në nivelin e mallrave të tregtuar për të vërtetuar analizën paraprake. Në këtë studim, ITP dhe RITP përdoren për të definuar lidhjen indikative në mes potencialit për eksport të Kosovës dhe kërkesës së importit të Shqipërisë gjatë një viti për të dy nivelet: ai sektorial (të zërthyer në bazë të industrive si pas NACE seksioneve dhe divizioneve) dhe ai i mallrave individuale të tregtuar. Duhet të kihet parasysh se ky model supozon që eksporti i një shteti prej një sektori të caktuar reflekton fuqinë prodhuese në atë sektor të atij shtetit, ndërsa sasia e importit nga një sektor i caktuar i një shteti po ashtu reflekton kërkesën e po atij sektorit të atij shteti.⁹ Megjithatë, meqë ITP dhe RITP janë vetëm tregues indikativ të potencialit për tregti të secilit shtet, ata indikatorë duhet të merren parasysh së bashku me indikatorë tjera për potenciale të tregtisë. Gjithashtu, për të pasur një pasqyrë më të qartë të shkëmbimeve tregtare në nivel të sektorëve apo industrisë, ky studim shfrytëzon edhe indeksin Grubel-Lloyd të nivelit të bashkëpunimit tregtar ndër-sektorial.

ITP konstruktohet në këtë mënyrë:
 $ITP = \min(x_{ki}, x_{kj}) - x_{kij}$, ku x_{ki} është vlera totale e eksporteve të shtetit i në botë që vijnë nga sektori apo produkti k , x_{kj} është vlera totale importit të shtetit j nga bota që vijnë nga sektori apo produkti k , dhe x_{kij} është vlera totale e eksporteve nga shteti i në shtetin j për sektorin apo produktin k . Kjo njësi matëse identifikon plotësimin e tregut bilateral në mes shtetit importues dhe atij eksportues. Një ITP e lartë në një sektor të caktuar ekonomik apo pro-

Analiza e potencialeve të tregtisë në mes Kosovës dhe Shqipërisë është e bazuar në metodologjinë e Qendrës Ndërkombëtare për Tregti (ITC), e cila sygjeron disa metoda studimi për nivele të ndryshme analitike.

dukt gjatë një viti është shenjë paralajmëruese se ekziston një potencial tregtie në mes dy shteteve në atë sektor apo produkt. Ky model merr parasysh edhe RITP e cila është pjesa e ITP në x_{ki} , apo $RITP = (ITP/(x_{ki}) \times 100)$. RITP përcakton në bazë të përqindjes nivelin e potencialit indikativ për tregti.

Në anën tjetër, indeksi Grubel-Lloyd kalkulohet përmes formulës në vijim:

$$GL_i = 1 - \frac{|X_i - M_i|}{X_i + M_i}$$

X_i - Eksportet e Kosovës nga sektori (i) në Shqipëri
 M_i - Importet e Kosovës në sektorin (i) nga Shqipëria.
Vlerat e këtij indeksi mund të janë nga 0 deri 1, ku sa ma e lartë është vlera e indeksit, aq më i lartë është niveli i bashkëpunimit tregtar në sektorin respektiv.¹⁰

⁹ Ibid, 11.

¹⁰ Në rastet kur indeksi arrinë 1, vlera e importit dhe eksportit është identike, ndërsa në rastet kur indeksi është 0 kemi vetëm tregti të njëanshme në atë sektor.

3. Regjimi tregtar

Në vitet e para të pasluftës, Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) vendosi një regjim të tregtisë së jashtme që kishte për synim përmirësimin e gjendjes ekonomike të Kosovës, dhe mbështetjen e rindërtimit që duhej të vinte si pasoje e luftës. Politikat tregtare të reja do t'i siguronin edhe të hyrat e Qeverisë së Kosovës përmes vendosjes së tarifës uniforme prej 10% në import për produktet e jashtme.

Më 7 korrik 2003, Republika e Shqipërisë dhe UNMIK në emër të qeverisë së Kosovës nënshkruan një marrëveshje për tregti të lirë. Kjo marrëveshje synoi t'i përmirësonte marrëdhëniet në mes të dy palëve dhe bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar përmes reduktimit gradual të tarifave në disa lloje mallrash dhe përfundimisht eliminimin total të tyre deri më datën 1 janar 2009.¹¹ Marrëveshja do t'i përfshinte pothuajse të gjitha produktet industriale. Tarifat bazë për produktet industriale nga dyja shtetet do t'i reflektojnë tarifat e parimit të kombit më të favorizuar, dhe gradualisht do t'iu nënshtroneshin reduktimeve të mëtejshme deri në eliminimin total të tyre.¹² Marrëveshja kishte synim lirimin nga barrierat edhe të produkteve bujqësore, mirëpo për dallim nga produktet industriale, produktet bujqësore duhej të tregtoheshin pa tarifa doganore që nga fillimi i marrëveshjes.

Dy vite më pas, përveç marrëveshjes tregtare me Shqipërinë, UNMIK kishte filluar të lidhë marrëveshje tregtare bilaterale edhe me shtete tjera të Ballkanit si Maqedonia Veriore (2015), Republika e Kroacisë (2006) dhe Bosnjë dhe Hercegovinë (2006). Megjithatë, këto marrëveshje u anuluan me hyrjen në fuqi të CEFTA në vitin 2007, e cila shndërrroi këto marrëveshje të shumta bilaterale në një marrëveshje të vetme rajonale.¹³

Marrëveshja e CEFTA-s synoi eliminimin gradual të barrierave të tregut deri në 31 dhjetor 2010. Tarifat dhe reduktimet e tyre të rekomanuara nga CEFTA përputheshin me tarifat e vendosura përmes marrëveshjeve bilaterale si për shembull ajo e UNMIK në emër të Kosovës dhe Shqipërisë. Përveç eliminimit të barrierave të tregut në produkte industriale dhe bujqësore përmes një rrjeti të marrëveshjeve bilaterale në mes anëtarëve të marrëveshjes, CEFTA synon të përmirësoj edhe ambientin investitor, të rris llojet e produkteve të shkëmbyera, etj.

Kosova dhe Shqipëria kanë vazhduar të lidhin marrëveshje tregtare mes tyre edhe pas anëtarësimit në CEFTA. Për të avancuar marrëdhëniet tregtare ato kanë nënshkruar disa marrëveshje më të vogla në fusha të veçanta të tregtisë të listuara më poshtë:

- I. Marrëveshjeve ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës (RKS) dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë mbi bashkëpunimin dhe Ndihmën Reciproke në Çështjet Doganore, nënshkruar në vitin 2009;
- II. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë mbi transportin rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, e nënshkruar me 22 korrik 2011;
- III. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për hapjen e doganave e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar ndërmjet RKS dhe RSH dhe kryerjen e veprimitarive të përbashkëta të kontrollit kufitar, të nënshkruar me 10 maj 2013;

¹¹ Marrëveshje për Tregtinë e Lirë Ndërmjet Misionit të Administratës së Përkohëshme Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në emër të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisë së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, faqe 2, Burimi: <https://bit.ly/2z7aBky>

¹² Parimi i kombit më të favorizuar ka të bëjë me tarifa të vendosura në mënyrë të njëratishme për se cilin shtet eksportues dhe pa diskriminime.

¹³ Annex 1 to the Agreement on Amendment of and Accession to the Central European Free Trade Agreement. Consolidated Version of the Version of the Central European Free Trade Agreement (CEFTA 2006). Faqe 3. Neni 1. Burimi: <https://bit.ly/2ZadU57>.

-
- IV. Marrëveshja kuadër ndërmjet qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për bashkëpunimin në nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë. Ky marrëveshje kishte për qëllim përmirësimin e tranzitit nëpër mes të dy shteteve, sidomos në lehtësimin ligjor të tranzitit, rritjen e kapaciteteve të palëve për tranzit, shkëmbimin efikas të informacionit dhe dokumentacionit në lidhje me mallra në tranzit, përmirësimin e sistemit të deklarimit në dogana, dhe thjeshtësimin e procedurave për tranzit, e cila ishte nënshkuar më 11 janar 2014 për një kohëzgjatje të pacaktuar;
- V. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për përgjashimin nga TVSH në import për libra, produktet e përafërt me librin, gazetat, revistat, periodikët si dhe materialet e ngjashme të shtypit të publikuara në Republikës e Kosovë dhe Republikën e Shqipërisë, e nënshkuar me 28 mars 2014;
- VI. Protokoll ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë mbi shfrytëzimin e përbashkët të pajisjeve për kontrollin e kufirit, e cila ishte nënshkuar më 23 mars 2015 për një kohëzgjatje ta pacaktuar;
- VII. Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit të Republikës së Shqipërisë dhe Agjensisë Kosovare të Standardizimit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të Republikës së Kosovës mbi bashkëpunimin në fushën e standardeve nëpërmjet shkëmbimit të informacioneve dhe eksperëtive në lidhje me atë fushë, e cila ishte nënshkuar më 23 mars 2015 dhe e vlefshme deri sa AKS ta fitojë statusin e vendit Affiliate në CEN dhe CENELEC pasi që të jetë anëtarësuar paraprakisht në ISO/IEC. Më pas palët mund të vazhdojnë bashkëpunimin sipas nevojave përmes marrëveshjeve të reja.¹⁴
- VIII. Marrëveshje bashkëpunimi në mes Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë për bashkëpunim në fushën e hetimeve administrative si dhe hetimeve tatimore dhe doganore në mes dy palëve, e cila ishte nënshkuar më 03 qershor 2016 për një kohëzgjatje të pacaktuar;
- IX. Marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës së Republikës së Shqipërisë mbi njohjen e ndërsjellë të certifikatës së testim/kalibrim të tahografit të mjeteve rrugore, e cila ishte nënshkuar më 03 qershor 2016 më një kohëzgjatje deri në momentin e aderimit të Republikës së Kosovës në Marrëveshjen Evropiane;
- X. Protokoll në mes Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës dhe ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Shqipërisë për njohjen bilaterale dhe unifikimin e modeleve te certifikatave shëndetësore, veterinare dhe fitosanitare që do të shoqerojnë ngarkesat e kafshëve të gjalla, produkteve me origjinë shtazore dhe produktet bimore gjatë importit, eksportit dhe tranzit midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, e cila ishte nënshkuar më 26 nëntor 2018 për një kohëzgjatje të pacaktuar;
- XI. Memorandum mirëkuptimi ndërmjet agjencisë për pronësinë industrial të Republikës së Kosovës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale të Republikës së Shqipërisë. Ky memorandum kishte për qëllim themelimin e një mekanizmi fleksibil për udhëzimin dhe bashkëpunimin e te dy zyrave në fushën e pronësisë industrial, e cila ishte nënshkuar më 26 nëntor 2018 për një kohëzgjatje prej pesë vitesh me mundësi ripërtërimi prej një kohëzgjatjeje të njejtë.
-

¹⁴ Marrëveshjet janë siguruar përmës kërkesave zyrtare ndaj Qeverisë së Kosovës nga Institut i GAP dhe Riinvest

XII. Marrëveshjeve ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e procedurave të përbashkëta të kontrollit të hyrje/daljeve nëpërmjet tri pikave të kalimit kufitar: Qafë Prush Gjakovë, Vërmicë - Morinë dhe Glloboçicë - Borje;

XIII. Vendimi për lejimin e kryerjes së procedurave të zhdoganimit dhe të kontrolleve fizike nga zyrtarët e zyrës doganore të Kosovës në portin e Durrësit dhe Porto-Romano dhe njohjen e licencave të agjencive të përfaqësimit doganor të Kosovës. Ky vendim është marrë nga Qeveria e Shqipërisë me datë 23 nëntor 2018.¹⁵

Në të ardhmen, në rast se Shqipëria anëtarësohet në Bashkimin Evropian para Kosovës, tarifat e importit nga Shqipëria në Kosovë dhe një pjese e madhe e çështjeve tregtare do të rregullohen përmes Marrëveshjes për Stabilizm dhe Asociim (MSA) dhe nuk do të mund të rregullohen me marrëveshje bilaterale. Në vitin 2015, Kosova nënshkroi MSA-në që ka për synim bashkëpunimin ekonomik, ligjor, dhe politik me shtetet e Bashkimit Evropian, gjë që u fuqizua në vitin 2016. MSA-ja gjithashtu ka për qëllim krijimin e një bashkëpunimi për treg të lirë përmes eliminimit të tarifave doganore në mes Kosovës dhe BE-së.¹⁶

15 Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 710, datë 23.11.2018, Burimi: <https://bit.ly/31NsqkV>

16 Stabilisation and Association Agreement Between the European Union, of the One Part, and Kosovo*, of the Other Part. Faqe 3-4. Neni 1. Burimi: <https://bit.ly/2YXgVlv>.

4. Tregtia e mallrave në mes Kosovës dhe Shqipërisë

Në bazë të të dhënave të Eurostat, në vitin 2018 Kosova kishte në total importe prej 3.3 miliardë euro dhe eksportë prej vetëm 329.5 milionë euro. Në tabelën 1 shihet se partneri tregtar kryesor i Kosovës gjatë vitit 2018 ishte Serbia me një shkëmbim total të mallrave prej 419.9 milionë euro, ndërsa Shqipëria zë vetëm vendin e pestë më vlerë totale të mallrave të shkëmbbyera prej 270.7 milionë euro. Rezultati ndryshon nëse konsiderohet vetëm ana e eksporteve, ku Shqipëria është destinacioni i parë i mallrave të Kosovës që në vitin 2018 arritën 65.9 milionë euro (20% të eksportit total). Mirëpo, nga perspektiva e importeve, Shqipëria renditet vendi i pestë prej të cilit Kosova importoi mallra me vlerë prej 204.8 milionë euro në vitin 2018 (6.1% të importit total), ndërsa vendi i parë ishte Gjermania prej të cilit Kosova importoi 391.6 milionë euro në 2018 (11.8% të importit total). Edhe gjatë periudhës 2004-2018, Shqipëria ishte kryesishët destinacioni i parë i eksporteve të Kosovës, ndërsa importet prej Shqipërisë gjithmonë përballeshin me konkurrencë prej shteteve tjera Evropiane dhe Kinës.¹⁷

 **Tabela 1.** Dhjetë partnerët tregtar kryesorë në bazë të vlerës së totalit të mallrave të treguar gjatë vitit 2018, në mijëra euro

RANGIMI	PARTNERI	SHKËMBIMI TOTAL	EKSPORTI	IMPORTI	BILANCI TREGTAR
1	Serbia	419,861	32,032	387,829	-355,797
2	Gjermania	414,890	23,293	391,597	-368,304
3	Turqia	341,529	6,536	334,993	-328,457
4	Kina	311,881	1,401	310,480	-309,078
5	Shqipëria	270,673	65,873	204,800	-138,926
6	Maqedonia e Veriut	212,367	41,521	170,846	-129,324
7	Italia	211,259	6,703	204,556	-197,853
8	Greqia	125,523	1,492	124,031	-122,538
9	Slovenia	108,784	13,634	95,150	-81,516
10	Polonia	90,212	5,041	85,170	-80,129
Gjithsej		3,650,829	329,496	3,321,333	-2,991,836

BURIMI: EUROSTAT

17 Shih aneksin A. 1. dhe A. 2.

Në tabelën 2 shihet se prej një perspektive rajonale të shteteve anëtarë të CEFTAs, Serbia është poashtu partneri tregtar kryesor i Kosovës, ndërsa Shqipëria zë vendin e dytë. Megjithatë, prej anës së eksporteve të Kosovës, Shqipëria mbeti destinacioni kryesor gjatë vitit 2018. Vendin e dytë e zë Maqedonia e Veriut ku u eksportuan mallra me vlerë prej 41.5 milionë euro (11.9% të eksporteve totale), ndërsa vendin e tretë e zë Serbia ku u eksportuan mallra me vlerë prej 32 milionë euro (12.6% të eksportit total). Në anën e importeve të Kosovës, Serbia zuri vendin e parë gjatë vitit 2018 prej ku u importuan mallra me vlerë prej 388 milionë euro (11.6% të importeve totale). Vendin e dytë e zuri Shqipëria prej ku u importuan mallra me vlerë prej 204.8 milionë euro (6.1% të importeve totale), ndërsa vendin e tretë e zuri Maqedonia e Veriut prej ku u importuan mallra me vlerë prej 170.8 milionë euro (5.1% të importeve totale).

 **Tabela 2.** Tregtia e jashtme me anëtarët e CEFTA 2018, në mijëra euro

PARTNERI	PARTNERI	SHKËMBIMI TOTAL	↑	↓	↔
			EKSPORTI	IMPORTI	BILANCI TREGTAR
1	Serbia	419,861	32,032	387,829	-355,797
2	Shqipëria	270,673	65,873	204,800	-138,926
3	Maqedonia e Veriut	212,367	41,521	170,846	-129,324
4	Bosnia dhe Hercegovina	76,808	7,688	69,120	-61,432
5	Mali i Zi	34,645	18,436	16,209	2,227
6	Moldavia	486	7	479	-473

BURIMI: EUROSTAT


Edhe prej një këndvështrimi të një periudhe shumëvjeçare, tregtia me partnerët tregtarë nuk ndryshon shumë. Në bazë të figurës 1, shihet se përashtuar vitet 2005, 2006 dhe 2016, Shqipëria ishte destinacioni i parë i eksporteve të Kosovës. Mirëpo, Kosova në vazhdimësi ka importuar më shumë nga Serbia krahasuar me Shqipërinë.¹⁸ Sa i përket vendeve të CEFTAs, përashtuar Malin e Zi dhe Moldavinë, deficiti tregtar me anëtarët tjerë, e sidomos ai me Serbinë vazhdimisht është rritur gjatë periudhës 2005-2018.¹⁹

18 Shih aneksin A. 4.

19 Shih ankesin A. 5.



Figura 1. Partnerët tregtar kryesor për eksport në CEFTA 2004-2018, në mijëra euro




Burimi: Eurostat

Të dhënat e shkëmbimeve tregtare tregojnë që shkëmbimet tregtare Kosovë – Shqipëri në vazhdimesi janë rritur si vlerë dhe si peshë në totalin e shkëmbimeve tregtare të Kosovës. Në vitin 2005 tregtia në mes të Kosovës dhe Shqipërisë ishte relativisht e ulët në bazë të vlerës së mallrave të tregtuara. Eksportet e Kosovës në Shqipëri ishin rrëth 5.2 milionë euro në vlerë (3.2% e eksporteve totale), ndërsa në të njëjtin vit, Kosova importoi mallra prej Shqipërisë në vlerë totale prej 18 milionë euro (1.9% e importeve) që rezultoi në një deficit tregtar prej 12.8 milionë (Figura 2). Në vitet në vazhdim të dy palët patën një rritje të konsiderueshme të shkëmbimeve tregtare, ku një prej faktorëve të rritjes mund të jetë edhe anëtarësimi në CEFTA, marrëveshje e cila hyri në fuqi në vitin 2007. Kjo shihet edhe në figurën 2 në rritjen e eksporteve gjatë vitit 2008 apo një vit pas anëtarësimit, kur Kosova eksportoi mallra me vlerë prej 21.4 milionë euro në Shqipëri (gati trefish më shumë se sa në vitin 2005), ndërsa importoi mallra nga Shqipëria me vlerë prej 62.3 milionë euro (rrëth dyfish më shumë se sa në vitin 2005). Duhet të kihet parasysh që gjatë periudhës 2005-2008, importet e Kosovës edhe prej anëtarëve të tjerë të CEFTA-s u rritën për 220.9 milionë euro apo 48.6%, ndërsa eksportet në anën tjetër në vendet tjera anëtare shënuan rritje prej 33.1 milionë euro apo u dyfishuan. Trendi i rritjes së importeve nga Shqipëria u ndal në vitin 2016 kur Kosova pati një ulje të importeve nga Shqipëria për 31.5 milionë euro apo 21.9% me pak se në vitin 2015. Megjithatë, në vitin 2017 rritja e importeve u rikthye, dhe në vitin 2018 u rritën për 92.1 milionë euro apo 81.6% më shumë se sa në vitin 2016, gjë që vinte prej importit më të shtuar të xehoreve të nikelist, shufrave të çelikut apo gize, vajrave të naftës etj.

Edhe pse trendi i eksporteve ishte pozitiv gjatë shumicës së periudhës 2005-2018 për të dy shtetet, deficiti tregtar në mes tyre është rritur vazhdimesht që nga viti 2008. Gjatë vitit kur Kosova dhe Shqipëria u anëtarësuan në CEFTA (2007) Shqipëria eksportoi mallra me vlerë prej 17 milionë euro më shumë se sa Kosova në Shqipëri. Për kahasim, në vitin 2018 deficiti tregtar në mes Kosovës dhe Shqipërisë ishte rritur në 139 milionë euro, gjë që është tete fish më i lartë se në vitin 2007 (Figura 2).



Figura 2. Tregtia e mallrave me Shqipërinë gjatë periudhës 2004-2018, në mijëra euro



Nëse shiqojmë shkëmbimet tregtare në bazë të sektorëve industrial, në vitin 2018 pjesa kryesore e mallrave të tregtuara nga të dy palët vinin nga sektori i prodhimit të produkteve (industritë përpunuese) të secilit shtet. Në tabelën 3 shihet se afro 69% e mallrave të Kosovës të eksportuara në Shqipëri i përkasin këtij sektori (seksioni C), ndërsa rreth 99% e mallrave të importuara nga Shqipëria janë nga po ai sektor. Më detajisht, pjesa kryesore e eksporteve të Kosovës në Shqipëri të këtij sektori vijnë prej prodhimit të pijeve alkoolike dhe jo-alkoolike me 19.4% të eksportit total që përfshijnë produkte si birra apo ujërat (divizioni 11), prodhimit të metaleve bazë me 13.8% të eksportit total që përfshijnë produkte si tubat e gizës dhe çelikut (divizioni 24), prodhimit të produkteve ushqimore të llojit të miellit të grurit (divizioni 10) me 11.9% të eksportit total, dhe prodhimit të produkteve prej gomës dhe plastikës të llojit të tubave dhe pllakave plastike (divizioni 22) me 7.4% të eksportit total. Përkundrazi, pjesa kryesore e importeve nga Shqipëria në këtë sektor vijnë prej prodhimit të metaleve bazë si për shembull shufra gize dhe çeliku (divizioni 24) me 49% të eksportit total, prodhimit të koksit dhe vajra të rafinuara të naftës (divizioni 19) me 15.9% të eksportit total, dhe prodhimit të produkteve jo-metalike të tjera si për shembull çimento portland (divizioni 23) me 12.4% të eksportit total. Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e eksporteve të Kosovës në Shqipëri i përkasin edhe sektorit të furnizimit me ujë, menaxhimit të ujërave të zeza, dhe menaxhimit të mbetjeve të proceseve të ndryshme të përpunimit të produkteve (seksioni E). Në tabelën 3 shihet se këto lloj mallra përfshijnë afro 30% të të gjitha mallrave të eksportuara në Shqipëri, ku pjesa kryesore vjen prej mbetjeve dhe mbeturinave metalike si për shembull të bakrit apo hekurit etj., dhe ato jo-metalike si për shembull të drurit apo plastikës (divizioni 38).


Tabela 3. Tregtia reciproke e Shqipërisë dhe Kosovës në seksione NACE në vitin 2018 (në mijëra euro)

NACE Seksioni	NACE Divizioni	Eksportet nga Kosova në Shqipëri		Importet në Shqipëri nga Kosova	
		në vlerë (Euro)	në % të eksporteve totale të seksionit në botë	në vlerë (Euro)	në % të eksporteve totale të seksionit në botë
A - Bujqësi, pylltari, dhe peshkim	01 - Prodhime bujqësore dhe shtazore, gjuetia dhe aktivitetet të ngjashme	169.162	0.26	415.136	0.20
	Sekcioni A	169.162	0.26	415.136	0.20
	10 - Prodhimi i produkteve ushqimore	7,834.757	11.89	19,387.163	9.47
	11 - Prodhimi i pijeve	12,803.111	19.44	2,858.103	1.40
	19 - Prodhimi i koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	29.305	0.04	32,591.941	15.91
	20 - Prodhimi i kemikaleve dhe produkteve kimike	1,350.440	2.05	5,062.318	2.47
C - Prodhimi i produkteve	22 - Prodhimi i produkteve të gomës dhe plastikës	4,903.018	7.44	1,218.639	0.60
	23 - Prodhimi i produkteve jo-metalike të tjera	1,631.649	2.48	25,437.984	12.42
	24 - Prodhimi i metaleve bazë	9,082.820	13.79	100,271.879	48.96
	28 - Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve të ndryshme	1,426.195	2.17	110.968	0.05
	32 - Prodhim tjetër	459.999	0.70	4,788.124	2.34
	Të tjera	5,930.280	9.00	11,185.171	5.46
	Sekcioni C	45,451.575	69.00	202,912.290	99.08
D - Furnizimi me elektricitet, gaz, avull dhe klimatizim	35 - Furnizimi me elektricitet, gaz, avull, dhe kondicionim l ajrit	350.808	0.53	640.714	0.31
	Sekcioni D	350.808	0.53	640.714	0.31
E - Furnizimi me ujë, menaxhimi i ujërave të zeza, dhe menaxhimi i mbetjeve	38 - Mbledhja, trajtimi dhe deponimit i mbeturinave; rikthimi i materialeve me vlerë	19,685.813	29.88	1.714	0.00
	Sekcioni E	19,685.813	29.88	1.714	0.00
G - Tregti me shumicë dhe pakicë; tregti dhe riparim i automjeteve motorike dhe motoçikletave	47 - Tregtia me pakicë, përveç e automjeteve motorike, dhe motoçikletave	96.565	0.15	0	0.00
	Sekcioni G	96.565	0.15	0.000	0.00
J - Informim dhe komunikim	58 - Aktivitete botimi	119.045	0.18	551.653	0.27
	Sekcioni J	119.045	0.18	551.653	0.27
R - Art, zbatuje, dhe rekreacion	90 - Aktivitete kreative, artistike, dhe argëtuese	0.204	0.00	278.139	0.14
	Sekcioni R	0.204	0.00	278.139	0.14
	Gjithsej	65,873.172	100.00	204,799.646	100.00

Burimi: Eurostat; Kategorizimi dhe kalkulimi: Instituti GAP dhe Institutti Riinvest

Në figurën 3 shihet se prej një perspektive më të gjatë kohore eksporti në Shqipëri nga sektori i prodhimit të Kosovës në mallra si pijet, produktet ushqimore, apo edhe produktet metalike (seksioni C), është zvogëluar gjatë periudhës 2009-2013 nga 18.1 milionë euro në vitin 2009 në 9.4 milionë euro në vitin 2013. Mirëpo pas vitit 2013 eksportet filluan të rriten dhe në vitin 2018 vlera e tyre arriti 45.4 milionë euro apo katër herë më shumë se sa në vitin 2013. Përkundrazi, mbetjet dhe mbeturinat metalike dhe jo-metalike të eksportuara në Shqipëri (seksioni E), pas një ngritjeje të konsiderueshme nga vit 2009 në vitin 2013 prej 15.2 milionë euro, filluan të ulen deri në vitin 2016 ku ishin vetëm 7.4 milionë euro. Megjithatë, ato filluan prapë të rriten dhe në vitin 2018 ishin 19.7 milionë euro apo 12.3 milionë euro më shumë. Në anën tjetër, importi në Kosovë i mallrave të sektorit të prodhimit të Shqipërisë si për shembull metalet bazë, koxi dhe produkte të naftës, dhe produkte të tjera jo-metalike (seksioni C), janë rritur dukshëm nga kur kishte 43.4 milionë euro në vitin 2019 deri në 143.5 milionë euro në vitin 2015. Megjithatë, në vitin 2016 importet e këtij seksioni patën një ulje prej 31.7 milionë euro në krahasim me vitin 2015, ndërsa rritja rikthyte në vitin 2017 dhe vazhdon të rritet.

Figura 3. Eksporti dhe importi në mes Kosovës dhe Shqipërisë i mallrave më të rëndësishëm sipas NACE, 2009-2018 (në mijëra euro)



Burimi: Eurostat; Kategorizimi: Instituti GAP/Instituti Riinvest

Në nivelin e produkteve specifike të tregtuara në bazë të kodeve individuale tarifore të tyre, shohim se ndër mallrat më të eksportuara të Kosovës dominojnë artikujt e metaleve bazë apo produktet prej tyre si për shembull mbetjet ferrike apo alumini, ose tuba metali. Kosova eksporton edhe produkte bujqësore si miell gruri ose patate. Në anën tjetër, Kosova importon nga Shqipëria kryesisht produkte të metaleve bazë si për shembull shufra metali apo alumini, dhe produkte me bazë minerale si për shembull vajra të naftës, çimento portland, apo koks nafte. Gjithashtu importohen edhe artikuj bujqësor si domate apo agrume, si dhe artikuj sanitari (shih tabelën 4).

Tabela 4. Tregtia reciproke e Shqipërisë dhe Kosovës në produktet më të rëndësishmë të tregtuara, 2018 (në mijëra euro)

EKSPORTET NGA KOSOVA NË SHQIPËRI		EKSPORTET NGA KOSOVA NË SHQIPËRI		
RANGIMI	PRODUKTI	VLERA NË EURO	PRODUKTI	VLERA NË EURO
1	Mbetje ferrike	16,844.832	Shufra gize apo çeliku	87,868.266
2	Birrë nga malti	8,828.737	Vajrat e naftës	22,237.146
3	Tuba gize apo çeliku te zgavruara	7,300.192	Çimento portland	22,178.284
4	Ujëra	2,852.370	Koks dhe bitum nafte	10,315.523
5	Mbetje alumini	2,832.284	Shufra alumini	5,779.514
6	Miell gruri dhe meslini	2,183.415	Artikuj sanitari	4,734.506
7	Tuba plastike	1,889.938	Domate	3,558.392
8	Patate	1,469.655	Shufra të tjera prej gize apo çeliku	3,377.903
9	Plakë plastike	1,233.005	Stuko	3,171.759
10	Tuba të tjera gize apo çeliku	1,100.508	Agrume	2,114.743
Eksporti total në Shqipëri		65,873.172	Eksporti total në Shqipëri	204,799.646

Burimi: Eurostat

5. Zbatimi i marrëveshjeve për lehtësimin e tregtisë

Megjithëse Kosova dhe Shqipëria kanë nënshkruar një numër të madh të marrëveshjeve, memorandumeve dhe vendimeve qeveritare që synojnë lehtësimin e bashkëpunimit tregtar. Për këtë qëllim, në tabelën e mëposhtme janë përmblledhur rezultatet e realizimit të 53 objektivave të nxjerra nga marrëveshjet tregtare Kosovë – Shqipëri. Shumica e këtyre objektivave (37 apo rreth 70%) dalin nga Marrëveshja kornizë për bashkëpunimin në nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë Kosovë - Shqipëri e nënshkruar në vitin 2014. Megjithëse ka një progres të mirë në realizimin e marrëveshjeve, siç do të flasim në seksionin për barrierat tregtare, ende shfaqen pengesa të tillë si: harmonizimi i akcivave, taksa të brendshme, çështje të sundimit të ligjit, mungesa e besimit në mes bizneseve etj., e të cilat pengesaa nuk rregullohen apo nuk mund të adresohen me këto marrëveshje. Në bazë të të gjeturave, 49% e këtyre objektivave janë realizuar plotësisht, 36% janë realizuar pjesërisht, 9% nuk janë realizuar fare ndërsa për tre objektiva nuk kemi mundur të marrim përgjigje. Në këtë kapitull gjithashtu, kemi bërë një analizë lidhur me procedurat për shkëmbimin e mallrave përmes zyrës së Kosovës në Portin e Durrësit.

Tabela 5. Realizimi i objektivave të dala nga marrëveshjet tregtare Kosovë – Shqipëri ²⁰

BURIMI	JO	PO	Pjesërisht	Pa përgjigje
Marrëveshje bashkëpunimi në fushat e standardizimit dhe akreditimit		1		
Marrëveshje mbi njohjen e ndërsjellë të çertifikatës së testim/kalibrim të tahografit të mjeteve rrugore		1		
Marrëveshje për njohjen e certifikatave veterinare dhe produkteve me origjinë shtazore dhe jo-shtazore	6		2	
Marrëveshje për përashtimin nga TVSH në import për libra, produktet e përaferta me librin, gazetat, revistat, periodikët si dhe materialet e ngjashmë të shtypit të publikuara në Kosovë dhe Shqipëri		1		
Marrëveshja kuadër për bashkëpunim në nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë	1	14	12	
Marrëveshja kuadër për bashkëpunim në nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë - Çështje të tranzitit	3	3	4	
Marrëveshja për pikat e përbashkëta të kalimit kufitar	1		1	1
Marrëveshje bashkëpunimi në fushën e hetimeve administrative, tatimore dhe doganore				2
Total	5	26	19	3

Burimi: Instituti GAP dhe Riinvest bazuar në vlerësimet e institucioneve dhe bizneseve Kosovare

20 Detajet për progresin në realizimin specifik të objektivave i gjeni në Aneksin B

Mungesa e mbajtjes së takimeve të rregullta në mes të grupeve teknike të institucioneve, të parapara sipas marrëveshjeve, është njëra nga ngecjet që mund të ndërlidhet edhe me problemet në realizimin e objektivave tjera të marrëveshjeve. Sipas përfaqësuesve të institucioneve nga Kosova, arsyje për mos mbajtjen e këtyre takimeve janë demotivimi për shkak të mungesës së kompetencave të këtyre grupeve për t'i zgjidhur problemet dhe varësia e madhe tek niveli politik.²¹ Sfidë tjetër për zbatim mbetet eliminimi i çmimeve arbitrale, të cilat janë aplikuar tek eksportet nga Kosova siç janë çokollata dhe patatet, megjithëse eliminimi i tyre është paraparë me marrëveshje që nga viti 2014.

Probleme tjera lidhur me zbatimin e marrëveshjeve janë edhe procedurat e dyfishta gjatë tranzitit të produkteve. Peshimi që bëhet në Shqipëri gjatë tranzitit, nuk merret për bazë në Kosovë dhe kërkohet të bëhet prapë në terminal doganor.²² Gjithashtu, dyfishim të procedurave ka edhe në procese si: fillimi dhe përfundimi i tranzitit, shlyerja dhe aktivizimi i garacionit me rastin e përdorimit të sistemeve të ndara në ASYCUDA.²³ Të gjitha këto procedura shkaktojnë vonesa dhe kosto tek bizneset kosovare qofshin ato importuese apo eksportuese.

Në fushën e bashkëpunimit në mes të dy institucioneve për sigurinë ushqimore, nuk janë realizuar plotësisht objektivat edhe në fushën e harmonizimit të standardeve për produktet ushqimore, bashkëpunimi në fushën e akreditimit të laboratorëve, harmonizimin e legjislacionit për kontolle me bazë riku dhe unifikimin e dokumentacionit për produkte me origjinë jo-shtazore. Shqipëria gjithashtu nuk është duke e publikuar online listën e operatorëve të biznesit e cila do të ndihmonte në qarkullimin e shpejtë të produkteve. Mos realizimi i këtyre pikave të parapara nga marrëveshja ka shkaktuar bllokadë të eksporteve kosovare për në Shqipëri siç janë: mielli, qumështi apo vezët.²⁴ Objektivë tjetër e cila është realizuar vetëm pjesërisht dhe që lidhet me përgjegjësitë e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI) është harmonizimi i ligjeve për antidumping dhe masat mbrojtëse në importe.

Funksionimi i Portit të Durrësit. Ideja e dhënies shtetit të Kosovës për shfrytëzim të një porti detar nga Shqipëria ka filluar të përmendet nga Qeveria e Shqipërisë që nga viti 2006, ku fillimisht ishte përmendur dhënia e Portit të Shëngjinit.²⁵ Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, kryeministri i atëhershëm i Shqipërisë kishte përsëritur një premtim të tillë, mirëpo kjo ide nuk ishte realizuar kurrë në praktikë edhe pse kishte pasur kërkesa nga institucionet Kosovare.²⁶ Ideja për hapjen e një pike të vetme doganore për mallrat Kosovare në njëren nga portet e Shqipërisë u rikthye në vitin 2015, mirëpo kësaj radhe kjo pikë pritej të hapej në Portin e Durrësit.²⁷ Kjo zyre u bë funksionale vetëm në janar të vitit 2019 dhe është mirëpritur nga bizneset kosovare duke marrë parasysh se Porti i Durrësit është porti që ofron mundësi për qarkullimin më të shpejtë dhe më të lirë të mallrave për dhe nga Kosova.²⁸

21 Intervistë me përfaqësues të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë

22 Intervistë me kompaninë transportuese Railtrans, Përgjigje me email, 7 tetor 2019

23 ASYCUDA është sistem kompjuterik për menaxhimin e doganave që përdoret për shumicën e procedurave për tregti të jashtme

24 Shih sektionin për barrierat jo-tarifore

25 Top Channel, Porti i Shëngjinit, ne sherhim te Kosoves, Burimi: <https://bit.ly/2MgqNr5>


26 Radio Evropia e Lirë, Ku mbeti premtimi që Portin e Shëngjinit ta shfrytëzojë Kosova? Burimi: <https://bit.ly/2odPXr>

27 Radio Evropia e Lirë, Rama dhe Mustafa - kufiri, pikë bashkimi dhe jo ndarjeje, Burimi: <https://bit.ly/33Vj6Nd>

28 Radio Evropia e Lirë, Kosova hap pikën doganore në Portin e Durrësit, Burimi: <https://bit.ly/2jiUai>



Figura 4. Krahasim i portave të Durrësit dhe Selanikut për tranzit të mallrave nga Kosova



Burimi: Railtrans

Megjithëse kjo pikë doganore është bërë për t'i përshpejtuar procedurat e tranzitit për mallrat që tregtohen në Kosovë, ende ka pengesa procedurale në funksionimin efikas të saj. Fillimisht, në vendimet e marra nga qeveria e Shqipërisë dhe e Kosovës është përmendur vetëm mundësia e kalimit të importit tranzit të Kosovës pa i përmendur fare eksportet.²⁹ Kjo ka shkaktuar problem për eksportuesit e Kosovës, të cilët për shkaqe procedurale nuk kanë mundur ta përdorin këtë port për tranzit të eksporteve të paktën deri në muajin maj, derisa sa është bërë një interpretim i marrëveshjes nga pala shqiptare.³⁰

Problem tjetër është edhe mbajtja në funksion e dy sistemeve paralele në sistemet e teknologjisë informative të Doganës së Kosovës dhe Shqipërisë. Pas nënshkrimit të marrëveshjeve, softuerët e ASYCUDA-s në të dyja vendet janë ndërlidhur dhe procedurat e thjeshtësuarë nga agjencionet doganore të të dyja vendeve mund të kryhen në një sistem të vetëm.³¹ Mirëpo, në dyja vendet ende funksionojnë paralelisht edhe sistemet e ndara, të cilat kanë funksionuar para marrëveshjeve. Sistemi i ndarë përdoret më shumë nga agjensionet në Shqipëri dhe një gjë e tillë shkakton dyfishim të procedurave – rrjedhimisht ngadalësim apo pengesë në qarkullimin e mallrave. Gjithashtu, ndikimi i doganierëve në këtë sistem është më i madh gjë që lë hapësirë për praktika korruptive.

Përveç funksionimit të sistemeve paralele, problem ka edhe me sistemin e integruar softuerik. Tranzitet e Kosovës që kalojnë përmes Durrësit duhet të kalojnë një procedurë “cross-border” që kryhet nga Dogana e Shqipërisë. Kjo procedurë përfshinë autorizimin për marrjen e shumës për skaner dhe mbylljen e tranzitit në vend arritje. Pagesa prej 22 eurosh paguhet për tranzitet Kosovare megjithëse ky skaner nuk ekziston fare tek zyra e Kosovës në Durrës dhe rrjedhimisht dërgesat nuk skanohen. Gjithashtu, shpesh shfaqen vonesa nga Dogana në Shqipëri me arsyetimin se për shkaqe teknike një procedurë e hapur nga Dogana e Kosovës nuk është shfaqur në sistemin e tyre. Arsyetim tjetër për vonesa në lejimin për kalim të produkteve apo mbyllje të tranzitit nga Dogana e Shqipërisë është edhe “fluksi i madh i punëve”. Për t'i shmangur këto vonesa pastaj përdoren praktika të korruptimit të doganiereve dhe kjo reflekton në rritjen e kostos për produktet që transportohen në ose nga Kosova.³²

29 Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendim nr. 09/76, Burimi: <https://bit.ly/2DVUaLé>, 21 nëntor 2018

30 Kompania transportuese Railtrans, Përgjigje me email, 7 tetor 2019

31 ASYCUDA është sistem kompjuterik për menaxhimin e doganave që përdoret për shumicën e procedurave për tregti të jashtme

32 Kompania transportuese Railtrans, Përgjigje me email, 7 tetor 2019

6. Barrierat tarifore dhe jo-tarifore

Megjithë lidhjet e afërta historike, kulturore dhe numrin e madh të marrëveshjeve tregtare të nënshkruara nga Kosova dhe Shqipëria, kompanitë kosovare përballen me pengesa të ndryshme qoftë teknike apo edhe tarifore gjatë ekportimit të produkteve në Shqipëri apo kalimit tranzit. Shqipëria renditet e dyta pas Serbisë, sa i përket barrierave të raportuara jo-tarifore nga bizneset Kosovare.³³ Këto të dhëna përpushten edhe me një studim të realizuar me bizneset eksportuese nga Kosova në vitin 2018, ku Shqipëria renditet e dyta pas Serbisë sa i përket pakënaqësisë me trajtimin nga autoritetet vendase të bizneseve kosovare.³⁴

Problemet kryesore të bizneseve të raportuara me Shqipërinë lidhen me pengesat që lidhen me dokumentacione fitosanitare, çmimet referente, akcizat diskriminuese, pagesat për skanerë dhe mjedisin e vështirë të të bërit biznes. Shumë nga problemet e identifikuara me eksportuesit Kosovar, burim të përbashkët e kanë korruptionin në nivele të ndryshme institucionale në Shqipëri. Kosova dhe Shqipëria ende nuk kanë arritur të krijojnë sisteme në dogana, ku zyrtarët nuk kanë diskrecion për të penguar qarkullimin e mallrave. Karakteristikë sa i përket barrierave tregtare me Shqipërinë është se ato zgjidhen për një kohë të caktuar dhe të njëjtat në mënyrë sistematike përsëriteren.³⁵ Disa nga pengesat më të shpeshta janë paraqitur në vijim.

- **Kërkesat për noterizim të analizës fitosanitare.** Një nga problemet më shpesh të cekura nga bizneset është kërkesa nga institucionet Shqiptare që çdo dërgesë të ketë kopje të noterizuar të analizës ose çertifikatë origjinale fitosanitare të veçantë për dërgesën. Shembull, nëse një kompani Kosovare merr një çertifikatë fito-sanitare për një sasi të caktuar të produktit dhe atë sasi e eksporton me disa maune, atëherë për secilin nga to do të duhej ta noterizoje kopjen e analizës. Një kërkesë të tillë nuk e kanë shtete tjera në rajon, madje as shtetet të Bashkimit Evropian. Këtë pengesë e hasin të gjitha produktet ushqimore dhe pjet siç janë: pjet energjike, vezët, çokollatat, lëngjet e frutave, biskota etj.
- **Kosto për skanerin në doganë.** Përderisa eksportet për në vendet tjera duhet të futen në skanerin e sigurisë në doganë vetëm në rastet kur sistemi paraqet rrezik të lartë të sigurisë, të tilla si kontrabandimi, trafikimi apo ndonjë çështje tjetër sigurie, të gjitha eksportet për në Shqipëri duhet të futen në skanerin e sigurisë. Kostoja për një kamion i cili kalon në skaner është 22 euro, ndërsa sipas një kalkulimi të përafërt, kostoja totale që paguajnë bizneset kosovare për skaner është rreth dy milionë euro në vit. Kompanitë kosovare që kanë eksportuar edhe në vende të Bashkimit Evropian janë shprehur se nuk kalojnë në procedurat e kontrollës për secilën dërgesë por vetëm 3-5% të sasisë.³⁶ Disa kompani kanë raportuar se janë detyruar të paguajnë për skaner edhe në raste skaneri kur nuk ka qenë fare funksional. Gjithashtu, siç u përmend më lartë, me gjithë hapjen e zyrës doganore të Republikës së Kosovës në terminalin e Durrësit, mallrat të cilat qarkullojnë përmes Shqipërisë duhet të paguajnë përfutjen në skaner të shtetit Shqiptar, megjithëse ky skaner nuk ekziston në pikën e Doganës së Kosovës.³⁷ Kosto e skanerit duhet të paguhet madje edhe për mallrat të cilat kalojnë tranzit në Shqipëri, qoftë për eksport apo import.
- **Çmimet referencë.** Probleme me çmimet referencë kanë pasur veçanërisht eksportet e çokollatës dhe patateve nga Kosova. Në rastin e eksporteve të çokollatës, Dogana e Shqipërisë kishte caktuar një çmim referencë prej 3.3 euro, në kundërshtim me faturat e paraqitura nga eksportuesi kosovar. Kjo pastaj reflekton në rritjen e pagesës së Tatimit mbi vlerën e shtuar dhe kostos së këtij produkti në tre-gun e Shqipërisë duke e bërë atë më të shtrenjtë. Megjithëse kjo barrierë nuk është përsëritur kohëve të fundit, si pasojë e kësaj barriere dhe barrierave tjera të lartpërmendura, një ndër eksportuesit nga

33 Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, "Barrierat Tregtare, Lehtësimi i tregtisë si mjet për eliminimin e tyre", Prill 2018, Burimi: <http://bit.ly/2VdDJmS>

34 GFA Consulting Group GmbH, Raporti mbi BJT që prekin eksportuesit kosovarë, Burimi: <https://bit.ly/2lOnuE4>

35 Intervistë me përfaqësues të Departamentit të Tregtisë në MTI, 16 korrik 2019

36 Intervistë me Astrit Panxhën, Drejtori i Klubit të prodhuesve të Kosovës, 6 shtator 2019

37 Intervistë me Besim Asllanin – Menaxher i përgjithshëm në kompaninë transportuese Railtrans, 23 shtator 2019

- Kosova tregon të jetë dekurajuar dhe eksporti për Shqipëri nga kjo firmë po bie nga viti në vit me gjithëse për shkak të afërsisë gjeografike është një treg tejet i përshtatshëm për eksport.³⁸
- **Kosto për tarifë rrugore.** Që nga shtatori i vitit 2019, të gjithë automjetet duhet të paguajnë një tarifë për kalimin në autostradën Milot-Morinë. Pagesa për kamionët bëhet sipas dy kategorive varësisht nga kapacitetet e kamionëve, rreth 17 dhe 23 euro.³⁹ Këtë pagesë e kanë konsideruar si shumë të shtrenjtë të gjithë eksportuesit nga Kosova, veçanërisht duke e krahasuar atë me pagesën e rrugës në Maqedoni për në Portin e Selanikut.
 - **Korrupsioni nga oficerët doganorë.** Disa biznese kanë raportuar pengesa të ndryshme që bëhen nga oficerë doganorë nga Shqipëria në rastet kur ata kanë diskrecion mbi procedura të caktuara doganore. Me qëllim të marrjes së ryshfetit, oficerë doganorë i vonojnë procedurat për orë të tëra ndërsa në raste tjera mallrat bllokohen me arsyetim të mos përshtatjes së dokumentacionit me dërgesën. Njëra ndër kompanitë më të mëdha të piave nga Kosova kishte pasur probleme të tillë me bllokadë të eksportit për shkak të pretendimeve për mospërshtatje të dokumentacionit me ngarkesën. Me dokumentacion dhe peshë të njëjtë, ky problem ishte zgjidhur pas ndërhyjes të një partneri biznesi në Shqipëri i cili ka lidhje joformale me institucionet.⁴⁰
 - **Mungesa e besimit në partnerë biznesor.** Ndër barrierat të cilat nuk lidhen me funksionimin e institucioneve është edhe mungesa e besimit tek partnerët e biznesit për shpërndarje të produkteve në Shqipëri. Sipas prodhuesve kosovar edhe dallimet kulturore kanë ndikuar negativisht në raportet biznesore.⁴¹ Mungesa e besimit tek qytetarët nga Shqipëria është e gjetur edhe nga një hulumtim i kryer me qytetarë të Kosovës, ku rreth 62% e të intervistuarve i konsideron shqiptarët e Kosovës më të besës së Shqiptarët e Shqipërisë.⁴²
 - **Akciza diskriminuese në sasi të alkoolit.** Për dallim nga Kosova, Republika e Shqipërisë aplikon një akcizë të përshkallëzuar për pijet alkoolike varësisht nga sasia e prodhuar brenda vitudit nga një prodhues vendor apo i huaj. Shembull, akciza për prodhuesit e birrës mbi 200 mijë hektolitra në vit është dyfish më e madhe se për prodhuesit nën këtë sasi. Ndërsa, për prodhuesit e verës me mbi 10 mijë hektolitra në vit, akciza është trefish më e madhe se për prodhuesit nën këtë sasi.⁴³ Sipas eksportuesve të këtyre produkteve, akciza e përshkallëzuar i bën më pak konkurrente produktet e tyre në tregun e Shqipërisë për shkak të ekzistencës së një numri të konsiderueshëm të prodhuesve të vegjël atje.⁴⁴
 - **Akciza në ambalazhë të plastikës.** Një akcizë tjetër e cila aplikohet në Shqipëri, është edhe akciza për ambalazhë të plastikës prej 35 lekë për kilogram. Kjo barrierë tarifore është raportuar nga eksportuesit e çokollatës dhe ujërave të ambalazhuara, për shkak se ndikon në rritjen e çmimit final të produktit.⁴⁵ Gjithashtu, për shkak që kjo akcizë është vetëm 10 lekë në kilogram për lëndën e parë për prodhuesit e plastikës në Shqipëri, produktet e importuara diskriminojnë negativisht dhe janë më pak konkurruese në treg.

Barrierë e zgjidhur

- **Harmonizimi i standardeve ushqimore – rasti i miellit.** Me 15 korrik 2014, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Shqipërisë (MBZHAUSH) kishte lëshuar një udhëzim “përpërcaktimin e treguesve të sigurisë së miellit të grurit të para paketuar, përtu’ shitur te konsumatori i fundit ose për prodhimin e produkteve tjera ushqimore”. Ky udhëzim rregullonte cilësinë dhe sigurinë e miellit të grurit për konsum njerëzor të përgatitur nga mielli i zakonshëm dhe prodhuesit dhe importuesit e miellit kishin afat deri me 30 shtator 2014 të fillonin zbatimin e standardeve të reja. Ndërsa tjetra, ky udhëzim specifikonte se niveli minimal

38 Intervistë me Drejtorin e përgjithshëm të kompanisë Kamila Chocolate, 18 shtator 2019

39 Telegrafi.com, Rruga e Kombit bëhet me pagesë, pagesat për çdo automjet, Burimi: <https://bit.ly/2lNF5p2>

40 Intervistë më menaxherin e përgjithshëm të njërsës nga kompanitë më të mëdha të prodhimit të piave në Kosovës, 16 shtator 2019

41 Intervistë me N.T.P Liri, 18 shtator 2019

42 Hulumtim me mostra reprezentative i kryer në vitin 2018 në Kosovës dhe Shqipëri nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur në Kosovë dhe Shqipëri

43 Ligj nr. 98/2018 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012, “për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Burimi: <https://bit.ly/2lET4q4>

44 Intervistë me Astrit Panxhën, Drejtor i Klubit të prodhuesve të Kosovës, 6 shtator 2019

45 Ligj nr.9975, datë 28.7.2008 për taksat kombëtare i ndryshuar, Burimi:

i proteinave duhej të ishte “12.5% mbi bazën e peshës së thatë”. Ishte pikërisht ky specifikim, i cili pastaj doli të ishte arsye për bllokim të eksportit të miellit të Kosovës drejt Shqipërisë.⁴⁶ Një bllokadë e tillë kishte vazhduar deri në vizitën e ministrit të atëhershëm Panariti në Agjencionin e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) në Kosovë më 8 tetor 2014. Sipas deklaratës për shtyp të lëshuar nga AUV, bllokada kishte ndodhur si pasojë e metodave të ndryshme laboratorike për testimin e mostrave të miellit, e cila pastaj kishte shkaktuar “keqkuptime” tek interpretimi i rezultateve tek autoritetet doganore shqiptare.⁴⁷ Eksporti i miellit nga Kosova për në Shqipëri ishte bllokuar edhe një vit më parë, mirëpo motivi kishte qenë mungesa e analizave të aflatoksinës (substancë kancerogjene).⁴⁸

Megjithëse sipas Nenit 2, pika A e marrëveshjes për tregti Kosovë- Shqipëri, theksohet se palët duhet të bashkëpunojnë për “harmonizimin gradual të legjislacionit dhe standardeve në fushën e sigurisë se produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore, shëndetit të bimëve dhe kafshëve me interes të ndërs-jellë”, një gjë e tillë nuk ishte bërë nga ana e dy shteteve me rastin e implementimit të udhëzimit “për përcaktimin e treguesve të sigurisë së miellit të grurit të parapaketuar, për t'u shitur te konsumatori i fundit ose për prodhimin e produkteve tjera ushqimore”. Kosova ka një ligj me anë të të cilit rregullohet çështja e sigurisë dhe cilësisë së miellit mirëpo nuk kishte në fuqi një bazë ligjore që specifikonte metodën e analizimit të treguesve të miellit, ashtu siç ishte e rregulluar në Shqipëri.⁴⁹

Me rastin e bllokimit të miellit, pala shqiptare kishte shkelur edhe pjesën e marrëveshjes sa i përket informimit dhe lajmërimit të palës tjetër. Sipas Nenit 2, pika E e marrëveshjes, palët duhet të bashkëpunojnë në “krijimin e mekanizmave të informimit dhe lajmërimit reciprok në rastet e produkteve që nuk plotësojnë kërkesat e sigurisë dhe të legjislacionit te pronësisë intelektuale”. Në Kosovë institucioni përgjegjës për kontrollimin, verifikimin dhe inspektimin e ushqimit dhe lëndës së parë në të gjitha nivelit e zinxhirit ushqimor është Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë. Kyeshefi i AUV, kishte deklaruar se nuk kishte marrë një lajmërim zyrtar lidhur me ndryshimin e standardit të cilësisë së miellit.⁵⁰ Edhe përfaqësues i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI) së Kosovës kishte deklaruar se lajmin për një vendim të tillë MTI e kishte pranuar vetëm pas ngritisës së shqetësimit nga bizneset.⁵¹

Harmonizimi i legjislacionit sa i përket matjes së proteinave në miell kishte ndodhur vetëm tri vite pas bllokades së eksportit të Kosovës për në Shqipëri. Me datë 31 mars 2015, MBZHAUSH nxori një udhëzim të ri administrativ, ku kësaj radhe kërkesa për nivelin minimal të proteinës në miell gruri dhe miell gruri durum ishte ulur në 9% përkatësisht 11.5%.⁵² Ndërsa, Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Kosovë një udhëzim të tillë e nxori në vitin gusht të vitit 2017. Sipas këtij udhëzimi niveli minimal i proteinës në miell duhet të ishte nga 9% deri në 12% varësisht nga tipi.⁵³

- **Licencimi i pjesërishtëm i barnave.** Sipas të dhënave të marra nga institucionet relevante si dhe vetë bizneset në industrinë farmaceutike në Kosovë, numri i barnave të licencuara në Kosovë për bizneset nga Shqipëria është shumë më i madh në raport me barnat e pranuara dhe licencuara të bizneseve Kosovare në Shqipëri. Gjithnjë duke u bazuar në këto burime, pavarësisht kërkesës për licencim për një numër më të madh të barnave, vetëm një numër i kufizuar (njëshifron) i barnave të prodhua në Kosovë mund të eksportohen në Shqipëri.

46 Lajmi.net, Mielli i Kosovës, si kundet, nuk i përbush standartet e Shqipërisë dhe BE-së, Burimi: <https://bit.ly/2oHxLax>, qasur me 14 tetor 2019

47 AUV, Nuk do të ketë bariera për tregtim të miellit nga Kosova për në Shqipëri, 09 Tetor 2014, Burimi: <https://bit.ly/35zRjeY>, qasur me 14 tetor 2019

48 Gazeta Shqip, Bllokada për Miellin e Kosovës, Zbulohet Urdhri i Ministrit Ruli, Burimi: <https://bit.ly/32gaOyO>, qasur me 14 tetor 2019

49 Fehmi Geci dhe Bardh Begolli, Instituti Bujqësor i Kosovës, Intervistë me telefon, 10 Tetor 2014

50 Lajmi.net, Mielli i Kosovës, si kundet, nuk i përbush standartet e Shqipërisë dhe BE-së, Burimi: <https://bit.ly/2oHxLax>, qasur me 14 tetor 2019

51 Lulzim Demolli, Këshilltar politik - MTI, Intervistë me telefon, 10 Tetor 2014

52 Republika e Shqipërisë – Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural, dhe Administrimit të Ujërave, Udhëzim administrative për përcaktimin e treguesve të sigurisë dhe cilësisë së miellit të grurit të parapaketuar, për t'u shitur te konsumatori i fundit ose për prodhimin e produkteve tjera ushqimore

53 MBPZHR, Udhëzim administrativ - Nr. 06/2017 për kushtet e veçanta të evidentimit, kontrollit dhe shenjëzimit të miellit, i cili vendoset në qarkullim të lirë në tregun e republikës së Kosovës, Burimi: <https://bit.ly/33Esq8b>

7. Potencialet për shkëmbime tregtare dhe tregtia ndërsektoriale

Tabela 6 paraqet indikatorët ITP dhe RITP dhe komponentët e tyre për tregtinë në mes Kosovës dhe Shqipërisë gjatë vitit 2018. Në rast se ITP dhe RITP të një sektori tregtie janë relativisht të mëdha, atëherë mund të thuhet se ekziston një potencial indikativ për tregti në mes të dy shteteve në atë sektor. Në bazë të kriterit të lartëpërmendur, dy sektorët me potencial më të madh përrritje të eksportave të mallrave nga Kosova në Shqipëri janë ai i prodhimit të mallrave (seksioni C) dhe sektori i furnizimit të energjisë elektrike (seksioni D). Prej sektorit të prodhimit të produkteve një pjesë e konsiderueshme (17.6%) e mallrave të eksportuara nga Kosova kishin për destinacion Shqipërinë. Mirëpo, vetëm një pjesë e vogël e mallrave të importuara në Shqipëri vijnë prej Kosovës (1.2%), gjë që sugjeron që ekziston një mosbarazim në mes ofertës dhe kërkesës së produkteve të atij sektori. Kjo rezulton në një potencial eksporti prej 212.7 milionë euro apo në terma relativ prej 82.4% të eksportit të Kosovës në këtë sektor që do të mund të absorbohej nga tregu në Shqipëri. Prej sektorit të furnizimit me energji elektrike vetëm një pjesë e vogël e eksportave të Kosovës i takoi Shqipërisë gjatë vitit 2018 (1.5%). Këto të dhëna gjithashtu shpërfaqin një potencial eksporti prej 23.1 milionë euro, apo 98.5% të eksportit të Kosovës në sektorin e energjisë do të mund të absorbohej nga Shqipëria. Sektori i bujqësisë (seksioni A), i minierave dhe gurthyesve (seksioni B), i tregtisë me pakicë (seksioni G), dhe i artit dhe argëtimit (seksioni R) janë relativisht të vogël në bazë të vlerës së mallrave të eksportuar, dhe mund të thuhet se nuk ekziston ndonjë potencial përrritje të eksportit në ata sektorë.

Tabela 6. Potencialet për tregti në mes Kosovës dhe Shqipërisë gjatë vitit 2018

Seksioni sipas NACE	Eksportet e Kosovës në botë (në mijëra euro)	Pjesa e Shqipërisë në eksportet e Kosovës (%)	Importet e Shqipërisë nga bota (në mijëra euro)	Pjesa e Kosovës në importet e Shqipërisë (%)	ITP (in euro)	RITP(%)
Bujqësi, pylltari, dhe peshkim	782.617	21.6	39,660.863	0.4	613.455	78.4
Miniera dhe xehrore	25.412	0.0	352.919	0.0	25.412	100.0
Prodhimi produkteve	258,208.097	17.6	3,710,725.814	1.2	212,756.522	82.4
Furnizimi me elektricitet, gaz, avull dhe klimatizim	23,448.465	1.5	102,810.809	0.3	23,097.657	98.5
Furnizimi me ujë, menaxhimi i ujërave të zesa, dhe menaxhimi i mbetjeve	46,491.382	42.3	41,729.103	47.2	22,043.290	47.4
Tregti me shumicë dhe pakicë; tregti dhe riparim i automjeteve motorike dhe motoçikletave	117.145	82.4	4,446.770	2.2	20.580	17.6
Art, zbavitje, dhe rekreacion	7.427	2.7	293.828	0.0	7.223	97.3

Burimi: Eurostat. Kategorizimi dhe kalkulimi: Instituti GAP dhe Institutti Riinvest.

Tutje, tabela 7 analizon potencialet për tregti në nivel të sektorëve industrial.⁵⁴ Prodhimi i metaleve bazë (divizioni 24), prodhimi i produkteve ushqimore (divizioni 10), prodhimi i produkteve të gomës dhe plastikës (divizioni 22), prodhimi i produkteve nga metale të ndryshme (divizioni 25), prodhimi i pijeve (divizioni 11) kanë më së shumti potencial indikativ për eksport më të shtuar nga Kosova në Shqipëri.⁵⁵

Tabela 7. Potencialet për tregti në mes Kosovës dhe Shqipërisë të divizoneve më të rëndësishmë të sektorit të prodhimit të produkteve (seksioni C) gjatë vitit 2018

Divizioni	Eksportet e Kosovës në botë (në mijëra euro)	Pjesa e Shqipërisë në eksportet e Kosovës (%)	Importet e Shqipërisë nga bota (në mijëra euro)	Pjesa e Kosovës në importet e Shqipërisë (%)	Indicative trade potential (in euro)	Relative indicative trade potential (%)
Metale bazë	83,730.237	10.85	208,864.099	4.35	74,647.417	89.2
Produkte ushqimore	40,706.112	19.25	555,405.081	1.41	32,871.355	80.8
Produkte nga goma dhe plastika	31,509.265	15.56	148,644.070	3.30	26,606.247	84.4
Produkte nga metalet	15,338.037	3.54	99,080.334	0.55	14,794.962	96.5
Pije	25,738.567	49.74	102,294.974	12.52	12,935.456	50.3

Burimi: Eurostat

Për t'i vërtetuar rezultatet e analizave në bazë të nivelit të sektioneve dhe divizoneve, duhet të analizohet edhe niveli i produkteve individuale të tregtuar. Tabela 8 paraqet potencialet indikative për tregti më të shtuar në mes Kosovës e Shqipërisë në bazë të produkteve individuale më të tregtuar (në bazë të HS kodeve të tyre katër shifrone) që përfshihen nga sektori i prodhimit apo seksioni C dhe D i NACE kategorizimit. Produktet më të eksportuara të Kosovës në botë dhe me ITP dhe RITP më të mëdha gjatë vitit 2018 që i përkisnin sektionit C ishin ferro-lidhjet (7202) tuba prej gize apo çeliku (7306), pajisje ndërtimi prej plastike (3925), ujërat e gazuar apo mineral me ëmbëltues (2202), dhe birra nga mali (2203). Megjithatë, potencial indikativ për tregti më të shtuar më së shumti kishin ujërat e gazuar apo mineral me ëmbëltues apo aromatizues, gjë që sipas kësaj analize do të mund të absorbohen nga tregu i Shqipërisë. Duhet të vihet re se nga seksioni D që përfshinë sektorin e energjisë elektrike, Kosova ka potencial tejet të madh për tregti më të shtuar të energjisë elektrike (2716) me Shqipërinë, që në vitin 2018 ishin rreth 23 milionë euro që do të mund të absorbohen nga tregu i Shqipërisë.

54 Sektorët industrialet në këtë tabelë reflektojnë shkëmbimet tregtare sipas divizoneve të ndara në nomenklaturën NACE.

55 Seksioni D është poashtu me rëndësi në bazë të ITP dhe RITP, mirëpo përbredha sektionit D qëndron vetëm divizioni 35, i cili ka të bëjë me sektorin e furnizimit me elektricitet. Për arsyet e mospërsëritjes divizioni 35 nuk paraqitet në tabelën 8.

Tabela 8. Potencialet për tregti në mes Kosovës dhe Shqipërisë në bazë të produkteve më të eksportuara të Kosovës gjatë vitit 2018

Produkti	Eksportet e Kosovës në botë (në mijëra euro)	Pjesa e Shqipërisë në eksportet e Kosovës (%)	Importet e Shqipërisë nga bota (në mijëra euro)	Kosovës në importet e Shqipërisë (%)	Indicative trade potential (in euro)	Relative indicative trade potential (%)
Ferro-lidhjet	31,959.829	0.0	4,291.403	0.0	4,291.403	13.4
Tuba gize apo çeliku	12,953.439	8.5	8,017.040	13.7	6,916.532	53.4
Pajisje ndërtimi plastike	11,133.741	3.3	6,319.805	5.9	5,948.946	53.4
Ujëra të gazuar	11,106.641	25.7	47,384.593	6.0	8,254.271	74.3
Birrë nga mali	9,029.909	97.8	30,718.430	28.7	201.172	2.2
Energji elektrike	23,448.465	1.5	102,810.809	0.34	23,097.657	98.5

Burimi: Eurostat

Përveç indikatorëve të mësipërm ITP dhe RITP, ky studim poashtu analizon në mënyrë të detajuar edhe nivelin e bashkëpunimeve tregtare në mes sektorëve/industrive të njëjta në të dy vendët. Për të vlerësuar nivelin e tregtisë ndër-sektoriale të produkteve të caktuara kemi kalkuluar indeksin Grubel-Lloyd, i cili gjenë përdorim të gjierë në teorinë e tregtisë ndërkomëtare. Në tabelën e mëposhtme sektorët e hijezuar (sektorët me vlerë të indeksit më të madhe se 0.5) tregojnë që vlera e eksportit apo importit në një sektor të caktuar nuk tejkalon dyfishin e vlerës së importit respektivisht eksportit në atë sektor. Gjithashtu duhet të theksohet që në këtë tabelë janë marrë parasysh vetëm ata sektorë ku vlera totale e tregtisë mes dy vendeve në 11 vitet e fundit është më e lartë se 5 milionë euro. Vlerat e indeksit të paraqitura ndër vite tregojnë që tregtia ndër-sektoriale është sistematikisht më e lartë në produktet e drurit, gurit, plastikës, pijeve, zarzavateve dhe drithërave.

Tabela 9. Indeksi ndër-sektorial Grubel-Lloyd

Kapitujt	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Produktet bulmetore, vezë të zogjve, dhe mjaltë natyrale	0.28	0.43	0.74	0.33	0.16	0.35	0.93	0.84	0.92	0.81	0.98
Zarzavatet e ngrënëshme, dhe rrënjet dhe tuberat përkatës	0.39	0.46	0.84	0.58	0.89	0.68	0.48	0.33	0.42	0.32	0.32
Frutat dhe arrat e ngrënëshme, lëkurat e agrumeve apo të pjeprave	0.08	0.01	0.02	0.00	0.03	0.02	0.00	0.00	0.01	0.01	0.02
Produktet e industrisë bluajtëse	0.02	0.01	0.00	0.16	0.06	0.01	0.01	0.13	0.01	0.02	0.10
Vajra dhe dhjamra prej kafshëve apo vegetate	0.14	0.41	0.24	0.06	0.01	0.05	0.07	0.91	0.06	0.69	0.51
Përgatitjet prej drithrave, të miellit, niseshtës apo qumëshit	0.60	0.86	0.84	0.60	0.42	0.23	0.16	0.33	0.40	0.35	0.25
Përgatitje prej zarzavateve, frutave apo pjesëve të tjera të bimëve	0.13	0.30	0.60	0.91	0.59	0.48	0.41	0.66	0.96	0.79	0.91
Pijet, alkoolet dhe uthullat	0.71	0.40	0.50	0.72	0.99	0.96	0.91	0.63	0.75	0.54	0.37
Mbetjet dhe kthimet nga industritë ushqimore	0.63	0.00	0.02	0.26	0.02	0.09	0.00	0.00	0.00	0.04	0.02
Kripërati; sulfuret; oksidet dhe gurët	0.47	0.44	0.06	0.16	0.04	0.04	0.01	0.05	0.01	0.00	0.01
Xeheroret, zgjyrat dhe hiri	0.01	0.01	0.05	0.00	0.00	0.04	0.84	0.00	0.01	0.13	0.01
Lëndët djegëse minerale	0.32	0.40	0.52	0.49	0.74	0.00	0.00	0.00	0.02	0.00	0.02
Ekstraktet ngjyrësë dhe tanike	0.47	0.56	0.65	0.44	0.11	0.16	0.25	0.30	0.21	0.21	0.21
Produkte të ndryshme kimike	0.11	0.34	0.27	0.53	0.05	0.16	0.73	0.33	0.13	0.03	0.16
Plastikat dhe artikujt prej tyre	0.46	0.54	0.96	0.86	0.63	0.53	0.51	0.58	0.64	0.51	0.40
Druri dhe artikujt prej druri, qomyri i drurit	0.41	0.80	0.80	0.80	0.88	0.83	0.92	0.72	1.00	0.99	0.75
Letra dhe kartoni	0.97	0.94	0.86	0.55	0.29	0.36	0.21	0.40	0.68	0.94	0.88
Artikujt prej guri	0.57	0.67	0.92	0.71	0.71	0.72	0.68	0.77	0.71	0.69	0.87
Produkte qeramike	0.66	0.54	0.91	0.05	0.02	0.02	0.03	0.01	0.02	0.16	0.12
Giza dhe çeliku	0.23	0.20	0.34	0.43	0.42	0.50	0.58	0.39	0.24	0.34	0.32
Artikujt prej gize dhe çelikut	0.23	0.43	0.89	0.74	0.61	0.64	0.56	0.98	0.43	0.35	0.33
Alumini dhe artikujt prej tij	0.77	0.08	0.63	0.40	0.18	0.44	0.67	0.79	0.69	0.57	0.57
Reaktorët nuklearë, kaldajat(bojlerët), makineritë dhe pajisjet mekanike, pjesët e tyre	0.09	0.11	0.39	0.31	0.18	0.20	0.07	0.47	0.26	0.41	0.22
Makineri dhe pajisje elektrike dhe pjesët e tyre	0.84	0.35	0.54	0.32	0.20	0.63	0.16	0.05	0.15	0.45	0.61
Mobileritë	0.36	0.37	0.41	0.17	0.20	0.24	0.19	0.17	0.16	0.37	0.34
Artikujt të ndryshëm të prodhuar	0.00	0.30	0.46	0.05	0.63	0.56	0.14	0.10	0.08	0.08	0.11

8. Përfundimet

Partneriteti tregtar mes Kosovës dhe Shqipërisë është i një rëndësie tejet të veçantë. Megjithatë deri më sot ky partneritet nuk ka arritur të shfrytëzoj potencialin përritje dhe avancim të mëtutjeshëm të këtij bashkëpunimi i cili do të rezultonte në përmirësim të mirëqenies së përgjithshme në të dyja vendet. Aktualisht Kosova arrin të eksportoj vetëm një pjesë të vogël të produkteve në Shqipëri në krahasim me importet nga Shqipëria në Kosovë. Në vitin 2018 Kosova eksportoi afro një të tretën e vlerës së mallrave që importoi nga Shqipëria. Mallrat më të eksportuar nga Kosova janë pijet e ndryshme alkoolike dhe jo-alkoolike, miell gruri, dhe tubat prej çeliku. Në anën tjetër, mallrat që kryesisht importohen nga Shqipëria përfshijnë produktet me bazë minerale. Qëllimi i anëtarësimit të të dy vendeve në CEFTA, ndër të tjera, ishte rritja e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar ndërmjet tyre. Megjithatë, edhe pse Kosova pati një rritje të eksportave në Shqipëri pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes, importet e Kosovës nga Shqipëria janë shumëfish më të larta se eksportet në Shqipëri.


Me qëllim të thellimit të marrëdhënieve tregtare, janë nënshkruar një numër i marrëveshjeve bilaterale. Qëllimet e tyre janë duke u realizuar pjesërisht, mirëpo disa prej barrierave tregtare nuk do të adresoheshin edhe po të realizoheshin këto marrëveshje në tërësi. Të dy shtetet përballen me korrupsion të përhapur, mungesë të stabilitetit ligjor dhe cilësi të dobët të institucioneve. Këta faktorë pastaj ndikojnë që të mos realizohet plotësisht potenciali tregtar në mes dyja vendeve. Në bazë të analizës të potencialevë indikative përritje më të shtuar në nivel të industrive, shihet se potencialet më të mëdha përritje të eksportit nga Kosova kanë sektori i prodhimit të produkteve, përkatësisht prodhimit të metaleve bazë, produkteve ushqimore, produkteve të gomës dhe plastikës, produkteve prej metaleve të ndryshme, mobilieve, dhe tekstileve jo përveshje. Në bazë të produkteve individuale të tregtuara, me më së shumti potencial përritje më të shtuar me Shqipëri është energjia elektrike e eksportuar nga Kosova.

Duke u bazuar në këto të gjitura, Instituti GAP dhe Riinvest rekomandon:

- Në mënyrë që të përshpejtohen procedurat e tranzitit, Dogana e Shqipërisë duhet të rris kapacitetet për verifikim të tranzitit nga Kosova në zyrën doganore të Kosovës në Durrës;
- Me qëllim të uljes së korrupsionit në pikat doganore dhe përshpejtësim të procedurave, Dogana e Shqipërisë dhe Kosovës duhet t'i eliminojnë sistemet e ndara për procedurat e tranzitit në platformën ASYCUDA;
- Në fushën e sigurisë së ushqimit të bëhet tutje harmonizimi i standardeve për produktet ushqimore, të rritet bashkëpunimi në fushën e akreditimit të laboratorëve, harmonizimin e legjislacionit për kontolle me bazë risku dhe unifikimin e dokumentacionit për produkte me origjinë jo-shtazore;
- Në mënyrë që të shmangen konfliktet tregtare në të ardhmen duhet që të harmonizohen ligjet për anti-dumping dhe masat mbrojtëse në importe;
- Ngashëm sikurse vendet në BE, Dogana e Shqipërisë të shmang futjen të gjitha mallrave në skanerin e sigurisë dhe të bëjë kontolle në bazë të riskut;
- Të ulet kostojta përraksë rrugore;
- Që të shfrytëzohen potencialet për shkëmbime tregtare, dyja shtetet duhet të punojnë në forcimin e sundimit të ligjit, zbatimin e kontratave dhe uljen e korrupsionit;
- Të krijohen programe të përbashkëta të cilat nxisin shkëmbimet tregtare Kosovë - Shqipëri qoftë përmes lehtësimeve financiare apo mbështetjes teknike të bizneseve;
- Të lidhen marrëveshje që harmonizojnë legjislacionin sa i përket akcizave apo taksave tjera të brendshme që janë bërë pengesë për konkurrencë të barabartë në mes të dyja shteteve;
- Të krijohen programe mbështetëse përrxitje të industrive të cilat kanë potencial të lartë për shkëmbime tregtare
- Të krijohen plane të veprimit me afate dhe aktivitete përrnivelin teknik;
- Qeveria e Kosovës dhe Shqipërisë duhet të bëjnë monitorim të rregullt të zbatimit të marrëveshjeve të nënshkruara dhe adresimin e ngjajeve në nivel teknik dhe politik;


Anekset

Aneksi A. 1. Dhjetë partnerët tregtar kryesor për eksport në bazë të vlerës së mallrave të tregtuar gjatë periudhës 2004-2018, në mijëra euro




Burimi: Eurostat.

Aneksi A. 2. Dhjetë partnerët tregtar kryesor për import në bazë të vlerës së mallrave të tregtuar gjatë periudhës 2004-2018, në mijëra euro




Burimi: Eurostat.

Anekxi A. 3. Bilanci tregtar me dhjetë partnerët tregtar kryesor për shkëmbime tregtare në bazë të vlerës së mallrave të treguar gjatë periudhës 2004-2018, në mijëra euro




Burimi: Eurostat

Anekxi A. 4. Partnerët tregtar kryesor për import në CEFTA në bazë të vlerës së mallrave të treguar gjatë periudhës 2004-2018, në mijëra euro



Burimi: Eurostat

Aneksi A. 5. Bilanci tregtar me dhjetë partnerët tregtar kryesor për shkëmbime tregtare në bazë të vlerës së mallrave të treguar gjatë periudhës 2004-2018, në mijëra euro



Burimi: Eurostat

Aneks B

Burimi	Institucioni	Indikatori	Vleresimi i hulumtuesve (Riinvest dhe GAP)
Marrëveshja për bashkëpunim në nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë	MTI	A është legjislacioni për masat mbrojtëse në importet i harmonizuar me legjislacionin përkatesë në Shqipëri?	PJESËRISHT
		A është legjislacioni për antidumping i harmonizuar me legjislacionin përkatesë në Shqipëri?	PJESËRISHT
		A është legjislacioni në fushën e të drejtës intelektuale i harmonizuar me legjislacionin përkatesë në Shqipëri?	PO
		A janë krijuar mekanizmat e informimit dhe lajmërimit reciprok për çështjet e legjislacionit të pronësisë intelektuale?	PJESËRISHT
		A ka shkëmbime të informacionit për mbrojtjen e drejtave tregtare dhe patentave?	PJESËRISHT
		A janë formuar grupe të përbashkëta pune në fushën e barrierave tregtare?	PO
Marrëveshje bashkëpunimi në fushat e Standardizimit dhe Akreditimit	MTI	A mbahen takime të rregullta dy herë brenda vitit?	JO
		A shkëmbehen falas të gjitha standartet në mes të Agjencionit Kosovar për Akreditim dhe institucionit homolog në Shqipëri?	PO
Marrëveshje mbi njojnen e ndërsjellë të çertifikatës së testim/ kalibrim të tahografit të mjeteve rrugore	MTI	Njohja e ndërsjellë e çertifikatës së testimit/ kalibrimit të tahografit të mjeteve rrugore	PO
Marrëveshje për përjashtimin nga TVSH në import për libra, produktet e përaferta me librin, gazetat, revistat, periodikët si dhe materialet e ngjashmë të shtypit të publikuara në Kosovë dhe Shqipëri	MTI	Përjashtim reciprok nga TVSH në import për libra, produkte të përaferta, gazeta, revista dhe periodikët	PO

Burimi	Institucioni	Indikatori	Vleresimi i hulumtuesve (Riinvest dhe GAP)
		Kosova i ka të harmonizuara me Shqipërinë standartet në fushën e sigurisë së produkteve ushqimore dhe joushqimore	PJESËRISHT
		Kosova i ka të harmonizuara me Shqipërinë standartet në fushën e shëndetit të bimëve dhe kafshëve	PO
		Me qëllim të shkëmbimit të informacionit me autoritetet Shqiptare, janë harmonizuar/standardizuar:	
		a) Informatat	PO
		b) Dokumentacionet	PO
		Kemi bashkëpunim me Shqipërinë në fushën e akreditimit të laboratorëve	PJESËRISHT
		Institucionet homologe shkëmbejnë dokumentet në mënyrë elektronike	PJESËRISHT
Marrëveshja për bashkëpunim në nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë	AUV	Kemi qasje në informacione paraprake (para arritjes së mallrave) përmallrat nga Shqipëria	PO
		Janë harmonizuar:	
		a) procedurat e akreditimit	PJESËRISHT
		b) njohja e rezultateve të përputhshmërisë	PO
		Bëhet njohja reciproke e certifikatave të akreditimit	PO
		Është harmonizuar legjislacion me qëllim të zbatimit të kontolleve me bazë rishku	PJESËRISHT
		Janë formuar grupe të përbashkëta pune në fushën e masave sanitare, fitosanitare dhe veterinare	PJESËRISHT
		Grupet punuese mbajnë takime të rregullta dy herë brenda viti	PJESËRISHT
Marrëveshje për njohjen e certifikatave veterinare dhe produkteve me origjinë shtazore jo-shtazore	AUV	Njihen nga dy palët modelet e certifikatave shëndetësore veterinare përmallrat e gjalla përmallrat e therjeve dhe mbarshimit	PO
		Njihen nga dy palët modelet e certifikatave veterinare përmallrat e origjinë shtazore jo-shtazore konsum human	PO
		Njihen nga dy palët modelet e certifikatave shëndetësore veterinare përmallrat e produkteve jo-shtazore konsum human	PO
		Njihen nga dy palët resultatet e planeve të monitorimit të mbetjeve të pesticidive në produkte me origjinë bimore	PO
		Njihen nga dy palët modelet e certifikatave fitosanitare përmallrat e gjitha produktet	PO
		Është unifikuar dokumentacioni përmallrat e produkteve me origjinë jo-shtazore	PJESËRISHT
		Njihet raportet e analizave të laboratorëve të referencës	PO
		Njihet lista e operatorëve të biznesit të ushqimit	PJESËRISHT

Burimi	Institucioni	Indikatori	Vleresimi i hulumtuesve (Riinvest dhe GAP)	
Marrëveshja përpikat e përbashkëta të kalimit kufitar	Dogana e Kosovës	Eshtë duke u zbatuar parimi “një ndalesë një kontrollë”	PJESËRISHT	
Marrëveshje bashkëpunimi në fushën e hetimeve administrative, tatumore dhe doganore	Dogana e Kosovës	<p>Eshtë themeluar Komiteti i Përbashkët i Ekspertëve (KPE)</p> <p>KPE mban takime të rregullta gjashtë mujore siç parashikohet me marrëveshje</p>	JO	
Marrëveshja përbashkëpunim në nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë	Dogana e Kosovës	<p>Eshtë caktuar personi kontaktues për çështje që kanë të bëjnë me hetimet doganore me Shqipërinë</p> <p>Janë krijuar Njësi të përbashkëta hetimore me Shqipërinë në fushën e hetimeve doganore</p>	<p>Ka ndërveprim mes sistemeve elektronike të Doganës së Kosovës dhe Shqipërisë</p> <p>Sistemi elektronik i Doganës së Shqipërisë është interoperabil me Doganën e Kosovës</p>	PO
		Janë harmonizuar dhe thjeshtëzuar procedurat e tranzitit	PJESËRISHT	
		Janë marrë hapa për përmirësimin e sistemit të deklarimit në doganë	PO	
		Eshtë reduktuar numri i shkëmbimeve jo elektronike me Doganën e Shqipërisë	PO	
		Aplikohet shkëmbimi i informacioneve paraprake (para arritjes së mallrave) me institucionet në Shqipëri	PO	
		Eshtë bërë harmonizimi i metodologjive përvlerësimin e riskut për produktet jo-ushqimore që paraqesin rrezik përsigurinë dhe shëndetin	PO	

Burimi	Institucioni	Indikatori	Vleresimi i hulumtuesve (Riinvest dhe GAP)
Marrëveshja kuadër për bashkëpunim në nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë - Çështje të tranzitit	Dogana e Kosovës	Përdoret një garanci e vetme për produkte jo ushqimore në dy vendet për procedurat e tranzitit	PJESËRISHT
Marrëveshja kuadër për bashkëpunim në nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë - Çështje të tranzitit	Dogana e Kosovës	Eshtë shmangur dyfishimi i procedurave të tranzitit në procese siç janë: a) peshimi dhe plumbosja e kamionëve b) fillimi dhe përfundimi i tranzitit c) shlyerja d) aktivizimi i garancive	JO PJESËRISHT PJESËRISHT PJESËRISHT
Marrëveshja kuadër për bashkëpunim në nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë - Çështje të tranzitit	Dogana e Kosovës	Çmimet arbitrale të referencës janë eliminuar	JO
		Eshtë bërë kategorizimi i produkteve me qellim të realizimit të kontrollave në terminale apo ambiente tregtare	PO
		Eshtë bërë kategorizimi tregtarëve me qellim të realizimit të kontrollave në terminale apo ambiente tregtare	PO
		Janë ndërmarrë hapa për të zhvilluar module të përbashkëta për vlerësim të riskut, profilizim të përbashkët të riskut dhe krijuimin e skemave për shkëmbimin e informacionit	PO
		Jane organizuar trajnime të përbashkëta në mes të dy doganave	JO

RINVEST
1995

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE 